



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
SANKSIONEVE

Data: 19 Prill 2021

Nr: 22

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR.13,  
DATË 16.04.2021 NGA NJË GRUP QYTETARËSH (ALEANCA PËR TEATRIN)

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan RUSMALI - Kryesues  
Elvin LAKO - Anëtar  
Elvis ÇEFA - Anëtar  
Koli BELE - Anëtar  
Ledio BRAHO - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

**Ankues:** Një grup prej 17 qytetarësh, z. Edmond Budina e të tjerë, (Aleanca për Teatrën);

**OBJEKTI:** Shqyrtimin dhe zgjidhjen në rrugë administrative ankesën e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit ndaj Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve.

**BAZË LIGJORE:** Neni 21, pika 1, shkronja "b", neni 124/1, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 136, pika 2, e ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", neni 18 shkronjat "a" e "b" të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve",

## **Rrethanat e çështjes:**

1. Më datë 26.03.2021 një grup prej 19 qytetarësh, z. Edmond Budina e të tjerë, i janë drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kërkesën për “heqjen nga lista e kandidatëve për deputet në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit të Shqipërisë të:  
  
z. Edi Rama, z. Anastas Angjeli, zj. Milva Ekonomi, z. Arben Ahmetaj, z. Ervin bushati, zj. Blerina Gjylameti, zj. Evis Kushi, z. Xhavit Bushaj, zj. Antoneta Dhima, z. Roland Xhelili, zj. Senida Mesi, zj. Anila Denaj, z. Vullnet Sinaj, zj. Artemis Dralo (Malo), z. Lefter Koka, zj. Dallëndyshe Bici, zj. Mirela Kumbaro, z. Toni Gogu, z. Plarent Ndreca, zj. Romina Kuko, zj. Klodeta Dibra, z. Etjen Xhafaj, zj. Arta Dollani, z. Ylli Shehu.”
2. Me shkresën nr.2719/1 prot., datë 10.4.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka informuar kërkuesit për procedurat ligjore të ndjekura nga ana e KQZ-së dhe për rezultatet e verifikimit të formularëve të deklarimit. Komisioneri ka konfirmuar se personat e listuar në kërkesë “*nuk rezulton të jenë në kushtet e ndalimit për kandidim, për të mos u zgjedhur ose emëruar*”.
3. Më datë 16.4.2021, 17 nga kërkuesit kanë paraqitur ankim në KAS dhe kërkojnë prej tij “*të shqyrtojë dhe të zgjidhë në rrugë administrative ankesën e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit ndaj Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve*”.
4. Ankimi iu paraqit KAS-it, i cili caktoi relator z. Ilirjan Rusmali dhe vendosi zhvillimin e seancës përgatitore për shqyrtimin e kërkesës ankimore në datën 19.4.2021, ora 11:30, duke thirrur në seancë ankuesit. Seanca përgatitore u zhvillua në praninë e ankuesve zj. Adriana Kalaja, z. Mehdi Malka dhe zj. Adriana Tolka, si dhe të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së. Pasi dëgjoi pretendimet e ankuesve dhe sqarimet e administratës së KQZ-së, lidhur me kompetencën, legjitimitimin e palëve, afatet dhe formën e ankimit,

## **KAS-i konstatoi:**

1. Lidhur me çështjen e afatit të ankimit vlen të konstatohet se kërkesa ankimore është paraqitur me bazë ligjore ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të ndryshuar. Afatet procedurale që lidhen me këtë ligj janë ato të shqyrtimit administrativ sipas Kodit të Procedurave Administrative. Ankesa është paraqitur 6 ditë pas daljes së shkresës (data 10.4.2021), për të cilën ankuesit kanë marrë dijeni më datë 13.04.2021, çka e bën atë të jetë brenda afatit të kërkuar nga ligji.

2. Lidhur me formën konstatohet se kërkesa ankimore nuk është përpiluar sipas formatit të KQZ-së, nuk ka referenca të sakta për bazën ligjore, nuk ka objektin e përcaktuar saktë (nuk ka një vendim ndaj të cilit ankohet), si dhe nuk ka referenca për dispozitat ligjore që pretendohet se janë shkelur, apo që sipas ankuesit mbështesin ankimin.
3. Ankesa ka për objekt kundërshtimin e shkresës nr. 2719/1 prot., datë 10.4.2021 (shkresa bashkëlidhur kërkesës ankimore). Ndaj një shkresë informuese nuk mund të bëhet ankim në KAS, sepse përndryshe ankimi do ishte pa objekt. KAS-i shqyrton ankesat ndaj akteve të Komisionerit (sipas pikës 2 të nenit 19 të K. Zgjedhor “*Aktet administrative bazë të Komisionerit në ushtrimin e detyrës janë vendimet, urdhrat dhe udhëzimet*”), ose ndaj mosveprimit të tij (pika 2 e nenit 124/1 të Kodit Zgjedhor, neni 128 i Kodit të Procedurave Administrative). Kërkesa ankimore nuk është bërë as kundër një akti të Komisionerit as kundër mosveprimit të organit administrativ. Disponimi i ankuesve është i parregullt dhe e bën kërkesën ankimore të jetë pa objekt të ligjshëm.
4. Lidhur me legjitimitimin, KAS-i konstaton se ankuesit kanë vënë në lëvizje KQZ-në në cilësinë juridike të një grupi individësh, jo si përfaqësues ligjorë apo të autorizuar të një personi juridik. Gjatë seancës përgatitore ankuesit deklaruan se “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit” nuk është person juridik, nuk është regjistruar si e tillë në gjykatë, nuk ka organe drejtuese dhe persona që disponojnë tagra përfaqësimi.
5. Sipas Kodit Zgjedhor, KQZ-ja vihet në lëvizje nga subjektet zgjedhore, në zbatim të të drejtave që u njeh ky ligj, si dhe me kërkesë të palëve të treta, në mbrojtje të interesave të tyre të ligjshme (neni 123/1 i KZ). Kërkuesit bëjnë pjesë në kategorinë “palë e tretë” dhe kanë detyrimin të vërtetojnë nevojën për mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme, nëse duan të vënë në lëvizje me kërkesë KQZ-në. Ankuesit nuk provuan të kenë një interes specifik të ligjshëm në raport me regjistrimin/çregjistrimin e kandidatëve të caktuar në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.4.2021. Interesi i ligjshëm duhet të ketë lidhje me një të drejtë ligjore të kërkuesve, e cila është cënuar ose rrezikon të cënohet nga veprimi i organit administrativ (regjistrimi i kandidatëve në zgjedhje) dhe e drejta e cënuar duhet të jetë specifike dhe e identifikueshme si e drejtë/interesi i kërkuesve. Në rastin e kërkuesve-individë interesi i ligjshëm nuk mund të mbulohet nga vokacioni politik i tyre, pozicionimi pro ose kundër kandidatëve të caktuar, mbështetja ose kundërshtimi i platformave politike të caktuara, gjykimi i tyre për të mirën apo dobinë publike, apo shqetësimi për mbarëvajtjen e institucioneve. Për këtë qëllim individët kanë në dorë votën dhe atë e disponojnë në liri të plotë.

6. Kërkesa ankimore referon në arsyetim për *“nevojën për plotësimin e një prej pesëmbëdhjetë kushteve të vendosura nga Bashkimi European për hapjen e negociatave”* ose rrezikun *“e zbrazjes së listave me kandidatë fitues dhe precedentin shumë të keq që mund të krijohet në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit të Shqipërisë”* për shkak se SPAK-u mund të kërkojë *“arrest me burg”* për kandidatët e kontestuar nga kërkuesit. Këto interesa të listuara, sado sublimë qofshin, janë gjenerike dhe nuk bëjnë të mundur lidhjen midis regjistrimit të kandidatëve të kontestuar me cënimin e të drejtave ligjore të kërkuesve. Mungesa e interesit të ligjshëm për ankuesit pengon legjitimitimin procedural të tyre si në raport me të drejtën për të vënë në lëvizje KQZ-në, ashtu dhe në raport me të drejtën e ankimit në KAS ndaj akteve të Komisionerit.
7. Kodi Zgjedhor u njeh individëve të drejtën për të informuar KQZ-në për *“fakte ose rrethana, që mund të përbëjnë shkelje të përcaktimeve ligjore me natyrë administrative ose penale në fushën e zgjedhjeve”* (neni 123/3 i KZ). Nga shpjegimet e dhëna në seancë përgatitore prej përfaqësuesve të administratës së KQZ-së, rezulton se kjo administratë ka konstatuar se kërkuesit nuk legjitimoheshin për të vënë në lëvizje KQZ-në me kërkesën për çregjistrim kandidatësh. Administrata dukshëm ka vlerësuar, se kërkuesit po informonin KQZ-në për procedimet penale e më gjerë ndaj kandidatëve të kontestuar, pra po vepronin në zbatim të nenit 123/3 të Kodit Zgjedhor (këtu e ka justifikimin shkresa informuese për ta).
8. Nga ana tjetër, edhe sqarimi i procedurës ligjore të verifikimit të integritetit të zyrtarëve e përforcon këtë konkluzion. Ligji përcakton verifikimin formal të vetëdeklarimeve nga KQZ-ja, pas hetimit fillestar në regjistrat shtetërorë, dhe hetimin e specializuar nga organet e prokurorisë, kur ka të dhëna për papajtueshmëri. Ndërhyrja e palëve të treta (jo subjekte zgjedhore) në këtë proces mund të bëhet vetëm me statusin procedural të subjekteve që janë në dijeni të fakteve ose rrethanave, të cilat *“mund të përbëjnë shkelje të përcaktimeve ligjore me natyrë administrative ose penale në fushën e zgjedhjeve”* (neni 123/3 i KZ). Të dhënat që vihen në dijeni prej palëve të treta mund të bëhen objekt i hetimit të specializuar nga ana e prokurorisë. Për KQZ-në, ato mund të shërbejnë si indicie për t’i përcjellë një çështje specifike prokurorisë për kompetencë, në rast se konstaton se informacioni i dhënë është relevant për verifikimin e integritetit. Ndërhyrja e palëve të treta nuk bart për ndërhyrësit të drejta procedurale, përtej të drejtave të parashikuara nga neni 123/3 i Kodit Zgjedhor.

9. Lidhur me bazën ligjore të deklaruar nga ankuesit vlen të theksohet se ligji nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” përcakton në listë ezauruese rrethin e subjekteve që bartin kompetencën e verifikimit të të dhënave të vetëdeklarimit për zyrtarët shtetërorë, të zgjedhur apo të emëruar, sikurse përcakton në listë ezauruese rrethin e subjekteve që mund të kërkojnë verifikimin e integritetit të tyre. Në listën e dytë bëjnë pjesë edhe jo më pak se 500 shtetas me të drejtë vote (pika 2 e nenit 7 të ligjit nr. 138/2015). Kërkuesit nuk e plotësojnë kushtin numerik që u jep atyre të drejtën për të kërkuar verifikim, ndërkohë që ligji i sipërcituar nuk ka asnjë dispozitë ku të mbështetet nisma e tyre për të kërkuar heqjen nga listat e kandidatëve, gjegjësisht për të kërkuar heqjen e mandatit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 136, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, neni 18 shkronja “a” e “b” të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, njëzëri KAS-i,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 13, datë 16.04.2021, të z. Edmond Budina e të tjerë për shkak se ankuesit nuk legjitimohen në të drejtën e ankimit, ankimi është pa objekt të ligjshëm dhe nuk ka bazë ligjore.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 (ditëve), nga shpallja e tij.

**Ilirjan RUSMALI - Kryesues**

**Elvin LAKO - Anëtar**

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Koli BELE - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar**

